

SPECIFIKIME TEKNIKE

Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane

Në të cilat përfshihen këto procese shërbimi pastrimi:

1. Transporti dhe largimi i mbetjeve urbane me mjete transporti teknologjike me kapacitet jo më të vogël se 10 dhe 5 ton, me mjete teknologjike me kapacitet deri në 3.5 ton dere me dere, deri 3.5 ton mbetje voluminoze dhe deri 3.5 ton mbetje inerte, me mjet deri 3.5 ton autofshesë
2. Shërbime mbi pastrimin e infrastrukturës dhe sipërfaqeve urbane

Transporti e largimi i mbetjeve urbane konsiston në:

- Ky shërbim do të kryhet gjatë natës nga ora 22⁰⁰ – 06⁰⁰. Sasia e mbetjeve urbane që do të transportohet me mjete teknologjike 10 dhe 5 ton çdo ditë është 58 ton, autofshesa do të fshijë 72 590 m². Ky shërbim do të kryhet gjatë ditës nga ora 09⁰⁰ – 17⁰⁰, mjete 3.5 ton çdo dite do të transportohen 8 ton, me mjete 3.5 ton çdo dite do të transportohen 2 ton mbetje voluminoze, me mjete deri 3.5 ton çdo dite do të transportohen 2 ton mbetje inerte,

Nga të cilat :

- Mesatarisht 58 ton në ditë do të transportohen nga vend – grumbullimet të përcaktuar sipas studimit të bërë paraprakisht në të cilat janë vendosur kontenierët; me mjete teknologjike me kapacitet jo më të vogël se 10 dhe 5 ton, koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6 dhe me kapacitet mbajtës 85% për shkak të densitetit të ulët dhe krijojnë volum.
- Dhe 8 ton në ditë me mjet 3.5 ton teknologjike me prese e me kapak anesore dora - dorës, direkt nga familjarët.
- Dhe 2 ton në ditë me mjet 3.5 ton teknologjike me vinc pas kabines së shoferit (kove ose grap) me krik për mbetjet voluminoze dhe larje 10 copë kontenierë në ditë.
-Dhe 2 ton në ditë me mjet 3.5 ton teknologjike me vinc pas kabines së shoferit (kove ose grap) me krik për mbetje inerte dhe rreth 1162.5 ton mbetje të riciklueshme.
- Vlerësimi i sasisë së mbetjeve urbane të cilat do të transportohen si më lart; do të bëhet sipas sasisë të peshuara në Landfill të shoqëruara me Fletë – Peshimi (flete pranimeve të mbetjeve urbane) për çdo mjet dhe për çdo ditë të konfirmuara nga Landfilli dhe vertetimi dhe permblledhjen mujore për çdo mjet, për çdo ditë e për çdo rrugë.
- Përlllogaritjet e shpenzimeve të përgjithshme në hartimin e Situacionit mujor, do të kryhen vetëm në bazë të Fletë– Peshimeve (flete pranimeve të mbetjeve urbane) për çdo mjet dhe për çdo ditë të konfirmuara nga Landfilli dhe vertetimi permblledhjes mujor---Vlerësimi i sasisë së mbetjeve inerte të cilat do të transportohen si më lart do të bëhet sipas sasisë të peshuara në Landfill të shoqëruara me Fletë – Peshimi (flete pranimeve të mbetjeve urbane) për çdo mjet dhe për çdo ditë të konfirmuara nga Landfilli për çdo mjet, për çdo ditë e për çdo rrugë dhe keto mbetje inerte pas peshimit do të transportohen në pikën e mbetjeve inerte të miratuar. Fletpeshimet do të jenë pjesë e përgjithshme të shpenzimeve në hartimin e situacionit mujor
- Bashkia për kohëzgjatjen e këtij shërbimi për Periudhën 07.12.2025 - 31.12.2027 ka parashikuar dhe vlerësuar që vendosja e **700 copë** kontenierëve të mbetjeve urbane me volum 1.1m³ me kapak me mekanizëm. Në Zonën e shërbimit ku do të pilotohen 5 rrugë dhe 50 shkolla të arsimit parauniversitar për ndarjen në burim të mbetjeve për plastikë, qelq dhe letër ku kontenierët do të kenë mbishkrimin përkatës sipas ndarjeve dhe me ngjyrat perkatese sipas rrymave të mbetjeve Në keto rrugë kontenieret duhet të jenë me volum 1.1 m³, gjithsej 236 cope dhe në shkolla 150 cope (80kg).
- Të gjithë kontenieret e tjere, pra 464 cope, duhet të jenë 1.1m³.
- Në të gjithë kontenieret e mbetjeve urbane duhet të vendoset mbishkrimi “Mbani Paster Qytetin”

- Vendosja e tyre do të bëhet në përputhje me Plan-vendosjen dhe hartën në të cilat janë përcaktuara të gjitha koordinatat për çdo Vend- grumbullim të mbetjeve urbane të përcaktuara nga Bashkia, të cilat janë pasqyruara në Hartat përkatëse, nga ku sëbashku me listën janë pjesë e dokumentave të Tenderit.
- Operatori ekonomik në zbatim të detyrimeve kontraktore, për çdo ditë duhet të zbrazë 700 copë kontenerë respektivisht nga 186 copë për çdo mjet transporti teknologjik 10 ton dhe 236 cope për çdo mjet teknologjik transporti 5 ton . Për çdo mjet transporti 3.5 ton vetëshkarkuese me presë, me kapak anësor. Për çdo mjet transporti 3.5 ton vetëshkarkues me vinc me kove pas kabines së shoferit do të largojë mbetjet urbane voluminoze në të gjitha pikat e vendgrumbullimit të mbetjeve. Për çdo mjet transporti 3.5 ton vetëshkarkues me vinc me kove pas kabines së shoferit do të largojë mbetjet urbane inerte në të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve
- Mjetet teknologjike, gjatë transportimit dhe largimit të mbetjeve urbane janë të detyruar që të pastrojnë nga mbetjet të hedhura për rreth kontenerëve, fshirjen me krah të sipërfaqes me rreze 3 m të V.G.M. dhe rivendosjen e kontenierëve në vendin e caktuar në mënyrë të rregullt dhe estetike, dhe në përfundim të këtij procesi përfshihet dhe dezinfektimi i kontenierëve dhe i zonës për rreth me gelqere me 5% përmbajtje klori.

Mjetet që do të përdoren

- Operatori ekonomik për realizimin dhe garantimin e transportimit të sasisë së mbetjeve urbane të gjeneruara, duhet të verë në shërbim mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme si më poshtë:
- Për transportimin e mbetjeve urbane me mjet teknologjike kërkohen 4 mjete 10-5 ton, të cilat të jenë të vitit të prodhimit pas vitit 2015.
- Këto mjete duhet të garantojnë, ngarkim fundor ose anësor me kapacitet mbajtës jo më pak se 85% e koeficientit mbushës, me raport kompaktimi 1:4 deri 1:6 .
- Për transportimin e mbetjeve urbane direkt nga familjarët dhe pikat e hapura, mjetet e transportit të jenë vetëshkarkuese dhe me kapacitet deri 3.5 ton jo më pak se 85% e koeficientit mbushës.
- Operatori i shërbimit për transportin e kontenierëve të mbetjeve urbane që do të lahen çdo ditë dhe transportin e mbetjeve voluminoze duhet të disponojë 1 kamioncin me vinc me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton.
- Mjetet e transportimit largimit të mbetjeve urbane, duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- Njëkohësisht edhe të gjithë kontenierët të destinuar për kryerjen e këtij shërbimi, duhet të mbahen të pastër dhe në gjendje të mirë teknike e funksionale, e në rast deformimesh dëmtimesh rrotash apo djegie të cilat çojnë në mos funksionimin e tyre për çdo shkak duhet të kryejnë riparimin e tyre.
- Të gjitha mjetet e përdorura për qëllim transportin e largimin e mbetjeve urbane duhet të shkruhet “Mbani pastër qytetin tuaj” dhe sëbashku me kontenierët të kenë numrin përkatës dhe mbishkrimin “Bashkia Elbasan”.

Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikëve të punimeve

- Bashkia paraprakisht ka bërë studimin e zonës së Shërbimit dhe ka përcaktuar vend - grumbullimet të mbetjeve urbane dhe numërin e kontenierëve për çdo vend - grumbullim në të gjithë zonën e Shërbimit, duke përgatitur dhe Hartat përkatëse për këtë qëllim.
- Operatori është i detyruar të zbatojë vetëm planifikimin dhe përcaktimin nga Bashkia Planin, dhe ndalohet kategorikisht të bëjë ndryshimin e tyre përgjatë kohëzgjatjes së këtij shërbimi.

- Ky plan mund të ndryshojë nga Bashkia sipas nevojave për përmiresimin e shërbimit dhe mirëorganizimit të tij ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në ifrastrukturë, por gjithmonë me miratim të Autoritetit të Bashkisë.
- Grafiku i shërbimit të pastrimit të qytetit, përgatitet nga Operatori ekonomik dhe miratohet për çdo fillim shërbimi. Keta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda kësaj periudhe.
- Në grafikun e punimeve për çdo proces shërbimi, duhet të përcaktohet:
 - ✓ Orari i fillimit të shërbimit.
 - ✓ Për çdo mjettransporti duhet të përcaktohet: lloji, targa dhe itinerari i lëvizjeve si për mjetet teknologjike dhe mjeteve të thjeshta vete shkarkuese që janë të destinuara të kryejnë shërbimin.
 - ✓ Numrin e operatorëve(punëtorëve) që janë pjesë e kryerjes së këtij procesi shërbimi.
 - ✓ Operatori ekonomik nuk mund të punojë e të paguhet pau miratuar paraprakisht detyrimet e mësipërme.
- Menaxhimi dhe planifikimi nga ana e Operatorit ekonomik për kryerjen e këtij shërbimi duhet të garantojë që; transporti dhe largimi i mbetjeve urbane të ngurta do të kryhen sipas kërkesve teknike dhe brënda orës 06⁰⁰
- Operatori i shërbimit ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe pas perfundimit të shërbimit VGM, të shohë respektimin e kërkesave, rregullave dhe cilesinë e kërkuar.

Rregulla për t'u zbatuar

- Operatori ekonomik duhet të mbajë pastër VGM në përputhje me VKM. Nr.319 datë 31.05.2018 'Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane'
- Operatori i ekonomik ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që gjenerohen nga komuniteti, bizneset e institucionet të përfshira brënda Zonës së Shërbimit.
- Operatori ekonomik duhet të informojë me shkrim Bashkinë në mënyrë periodike për të gjitha shërbimet ku të deklarojë numrin e mjeteve dhe punetoreve shtesë për këto shërbime, për të garantuar cilesinë e kërkuar të shërbimit të pastrimit.
- Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natën) në punë numrin e kërkuar të mjeteve. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbetjeve urbane nga kontenieret në akset kryesore të rrugëve para se të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i tyre.
- Përdorimi uniformave të punëtorëve që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm.
- Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një "zyrë kontaktimi" për marrjen e ankesave nga qytetarët për të gjitha proceset e shërbimit të pastrimit të parashikuara në shërbim. Kjo zyrë duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 08:00 deri me 16:30. Përfaqësuesi i operatorit duhet të jetë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Bashkisë që mund të kenë për të gjitha proceset e shërbimit të parashikuara në shërbim dhe për të dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orëve nga marrja e njoftimit.

Fshirja e rrugëve, shesheve dhe trotuareve me krahë (me fshesare)

- Bashkia edhe në këtë shërbim sipërmarrjeje për periudhën 07.12.2025 – 31.12.2027 ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotualet dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e Shërbimit.

Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", Tel:00355 54 400152 email:Bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

- Operatori i shërbimit do të fshijë me krahë dhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotualet e përcaktuara, në zonën që do të kryet shërbimi.
- Volumet e punës janë nxjerrë në bazë të sipërfaqeve të shesheve, rrugëve e trotuareve dhe frekuencave të shërbimit, të cilat janë të pasqyruara në listat emërtuese përkatëse

Specifikimet teknike dhe metodologjia

- Fshirje e pjesshme e rrugëve me punëtorë, konsiston në pastrimin (fshirjen me fshese) e shesheve, rrugëve e trotuareve nga pluhurat e materialeve të tjera të ngurta, organike dhe jo organike.
- Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve dytësore në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike.
- Punëtorët (fshesarët) që do të kryejnë këtë proces shërbimi pastrimi duhet të jenë të mireinformuar për respektimin e ketyre kërkesave në realizimin e volumit të punës së planifikuar.

Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës nga ora 22⁰⁰ – 06⁰⁰. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, përgatiten nga Operatori shërbimit dhe miratohen nga Bashkia për fillim shërbimi.
- Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda këtyre muajeve vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes në rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta, gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Bashkia këto ndryshime.
- Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: oraret e operimit në secilën rrugë dhe - trotuar, si dhe numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.
- Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- Bashkia ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar.

Rregulla për tu zbatuar

- Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër çdo sipërfaqe rruge dhe trotuari në përputhje në përputhje me VKM. Nr.319 datë 31.05.2018 ‘‘Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane’’Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të palarguara në to.

- Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe Bashkia dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.
- Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", Tel: 00355 54 400152 email: Bashkiaelbasan@elbasani.gov.al, web: www.elbasani.gov.al

- Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një here pa shpenzime. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse (Zaranikes dhe Manazderes) dhe zonat e gjelbra.
- Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.
- Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë. Operatori që do të kryejë këtë shërbim të sensibilizojë komunitetin, nepermjet mjeteve të edukimit publik:
- Për të mbajtur një qytet të pastër brenda standarteve bashkekohore. Të mos hidhen mbetje të ndryshme organike apo inerte në ambientet publike, në shtratet e perrenjeve të Zaranikes dhe Manasgjeres. Të mos parkohen automjete përpara vendeve të konteniervete mbetjeve urbane.

Mjetet dhe pajisjet

- Operatori ekonomik duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje: Fshesa, (duhet të jete e bute e perthyeshme dhe elastike, prej materiali plastik, shqop ose gjineshter, lopata (të pershtatshme për këtë proces pune).
- Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mire. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur me fshese, kruajtëse, lopata, kazane dore levizëse dhe karroca dore.

Mirëmbajtja e pjesshme

- Mirëmbajtja e pjesshme e shesheve, rrugëve dhe e trotuareve, konsiston në: Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë gjatë ditës të trotuareve shesheve dhe rrugëve kryesore, duke mbledhur dhe larguar të gjitha mbetjet e vogla dhe të mëdha të hedhura në sipërfaqet e tyre si rezultat i aktivitetit tregtar dhe të këmbësorëve, mbajtjen pastër gjatë ditës të koshave rrugorë dhe vendit rreth tyre
- Bashkia, ka parashikuar paraprakisht të gjitha rrugët që do të shërbehet me mirëmbajtje të plotë e të pjesëshme dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e shërbimit

Plani i punës dhe grafikët e punimeve.

- Shërbimi i mirëmbajtjes së pjesshme do të kryhet, nga ora 09⁰⁰ – 17⁰⁰ sipas grafikëve të miratuar nga Bashkia, me qëllim që gjatë gjithë ditës trotuarët sheshet e rruget e përcaktuara për shërbim të jenë krejtësisht të pastër ose duke u pastruar.
- Grafikët e punimeve për realizimin e këtij shërbimeve përgatiten nga sipërmarresi dhe miratohen çdo vit nga Bashkia. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Bashkia këto ndryshime.

Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", Tel: 00355 54 400152 email: Bashkia@elbasani.gov.al, web: www.elbasani.gov.al

- Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë:
- Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
- Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo segment rrugorë.
- Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- Bashkia ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga ky shërbim.

Rregulla për tu zbatuar

- Operatori i shërbimit duhet të mbajë të pastër të gjithë sipërfaqen e planifikuar në përputhje me Rregulloren “Për Administrimin e Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit të Qytetit” dhe në kushtet e këtij shërbimi. Për asnjë rast nuk do të lejohen trotuare rrugë sheshe të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to.
- Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të penalizohet sipas parashikimit në nenin “Sanksione”
- Operatori i shërbimit detyruesisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.
- Operatori i shërbimit duhet detyruesisht që të mirëmbajë shtratin dhe skarpitet e prroit të Manazderes, duke zbatuar volumet e punës e grafikët e shërbimit, si dhe është i detyruar të respektojë numrin e puntoreve të caktuar për këtë qëllim

- Gjatë procesit të mirëmbajtjes të pjeseshme e të plote gjatë ditës apo gjatë nates, të parashikuara në shërbim, i trotuareve, rrugëve e i shesheve ndalohej kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujërave të zeza, hidrantëve, në zgarat e pusetave të ujërave atmosferike, zonat e gjelbra, etj.
- Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrit të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballat me penalitete sipas këtij shërbimi dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.
- Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoka për mosplotësim të tyre. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", Tel: 00355 54 400152 email: Bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

Freskimi i rrugëve

- Freskimi (lagja) e rrugëve konsiston në : Freskimi i rrugëve do të kryhet me ujë të pastër dhe presion me sasi 1 liter/m² . Periudha e kryerjes së këtij shërbimi do të jetë Prill – Tetor të vitit 2026 (214 ditë pune) Prill – Tetor 2027 (214 ditë pune), në total 428 ditë. Freskimi i rrugëve do të realizohet sipas planit, duke hequr nga 2 ml në dy krahet e rruges në gjeresi 4 ml për arsye të parkimit të mjeteve.

Plani i punës dhe grafikët e punimeve

- Orari i kryerjes të këtij shërbimi do të jetë 05⁰⁰ – 09⁰⁰ dhe 15⁰⁰ 19⁰⁰ . Çdo rrugë kryesore dhe dytesore, përcaktuar sipas listës së rrugëve për shërbimin e freskimit e do të përfitojë shërbimin një herë në ditë sipas grafikëve të hartuar për këtë qëllim.
- Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të freskimit të rrugëve përgatiten nga Operatori ekonomik dhe miratohen nga Bashkia. Këta grafikë mund të ndryshojnë orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit sa here lind nevoja, pasi të jenë të miratuar nga Bashkia.
- Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë :
 - ✓ Oraret e operimit në çdo rrugë.
 - ✓ Llojin e mjetit teknologjik (autobotit) që do të kryejnë shërbimin
 - ✓ Numrin e punorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.
 - ✓ Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikëve të shërbimit.
 - ✓ Operatori i shërbimit do të kryejë freskimin me ujë të rrugëve të përcaktuara në listën emërtuese me volumet përkatëse, bashkëngjitur këtij shërbimi.

- Autoriteti kontraktues ka te drejte te inspektoje ne cdo kohe dhe ne perfundim kryerjen e shërbimit, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësise duke vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospermbushjen e tyre.

Rregulla për t'u zbatuar

- Bashkia do të inspektojë gjatë ose pas përfundimit të shërbimit për të siguruar efektivitetin e këtij shërbimi dhe cilësinë e kërkuar.
- Ky proces shërbimi do të kryhet vetëm pasi të jete kryer procesi i shërbimi të fshirjes me krah. Duke respektuar:
 - ✓ Freskimi do të kryhet me ujë të pastër me normativ 1liter/ m²
 - ✓ Shpejtësia e lëvizjes së mjetit gjatë kryerjes së shërbimit duhet të jetë në varësi të kapacitetit të pompës dhe normës së freskimit me ujë për cdo m²
 - ✓ Në të gjitha rastet kur nuk është nevoja kryerja e shërbimit të freskimit me ujë të rrugëve për shkak të kushteve atmosferike si shiu apo ngricë. Operatori i shërbimit nuk do ta kryejë këtë shërbim dhe për rrjedhim nuk do të paguhet.
 - ✓ Perfaqësuesit e Autoritetit kontraktor do të shënojnë në proces verbalet ditore dhe mujore të gjitha ditët dhe volumet e punës përkatëse që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i freskimit.

Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", Tel:00355 54 400152 email:Bashkiaelbasan@elbasani.gov, web: www.elbasani.gov.al

- Do të konsiderohet e pavlefshme kryerja e shërbimit në kushte të reshjeve të përshkruara si më sipër. Do të bëhet perjashtim vetëm kur kërkohet nga Bashkia për shkaqe të ndryshme.
- Bashkia do të stimulojë Operatorin e shërbimit të përdore burime të tjera për të siguruar ujin për freskimin e rrugëve.
- Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e kërkuar të mjetit (autobotit) dhe paisjeve për freskimin e rrugëve.

Mjetet dhe pajisjet

- Operatori i shërbimit duhet të verë në dispozicion dhe të përdore për plotësimin e detyrave kontraktuale të shërbimit të freskimit të rrugëve këto mjete:
 - ✓ Autoboti për freskimin e rrugëve të paisur me pompe dhe tub anësor për nxjerrjen e ujit me presion, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 000 litra uje.
 - ✓ Mjeti (autoboti) për freskimin e rrugëve duhet të jetë i regjistruara nga Bashkia, dhe të mbahet në gjendje të pastër dhe të mire si dhe të lyer.
 - ✓ Nje sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin e kërkesave të kontratës sipërmarrëse.

Larja dhe dezinfektimi i kontenierëve

Volumet e punimeve

- Operatori i shërbimit do të lajë dhe dizinfektojë 300 copë kontenierë te volumeve 1.1m³ dhe ne muaj ose mesatarisht 10 copë në ditë, sipas grafikëve të miratuar nga Bashkia. Ky shërbim do të kryhet për çdo ditë nga ora 11⁰⁰ – 14⁰⁰

Metodologjia

- Operatori i shërbimit do të grumbullojë dhe transportojë kontenieret çdo nate nëvendin e përcaktuar nga ai dhe të kryejë larjen e plotë dhe dizifektimin e tyre atje. Kontenierët do të largohen detyrimisht pas zbrazjes së plotë të tyre.
- Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi, operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm kontenieresh rezervë për të zëvendësuar çdo natë kontenieret e larguar për t'u larë.
- Kontenieret për mbledhjen e mbeturinave urbane detyrimisht lahen nga brënda dhe nga jashtë me ujë me presion, duke përdorur furçe dhe solucion larës. Me shërbim dizinfektimi kuptojmë realizimin e shërbimit të dizinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit.

Grafiket e punimeve

- Grafikët e punimeve për transportin, larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve, përgatitjen nga operatori i shërbimit dhe miratohen nga Bashkia.
- Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit, i cili nuk mund të punojë dhe të paguhet, pa miratimin paraprak të grafiku
- Bashkia ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë, vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane për të parë kryerjen e shërbimeve të sipërpermendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilesisë së kërkuar për këtë shërbim

Rregulla për t'u zbatuar

- Ky shërbim do të kryhet detyrimisht pasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbetjeve urbane.
- Të gjitha lëndët dizifektuese dhe aromatike që përzihen me ujin për larjen dhe dezifektimin e kontenierëve, pra përberja dhe leja e përdorimit të tyre miratohet më parë nga organet shtetërore shëndetsore. Mosmiratimi i lëndëve kimike të përdorura para përdorimit të tyre do të bëjë të pavlefshme këtë shërbim

Mjetet dhe pajisjet

- Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më pak se 1 (një) copë.
- Lëndë dezifektuese dhe aromatizuese (dezifektues kimik) për dezifektimin e kontenierëve.
- Operatori i shërbimit duhet të ketë të instaluar në autoparkun e tij depozite uji si dhe mjete pune (pompe dhe pistolete uji) për larjen me presion dhe dizifektimin e kontenierëve.
- Operatori mund të përdori si alternative tjetër për këtë proces shërbimi dhe mjete teknologjike të levizshme.
- Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë këmbimi rezerve me qëllim plotësimin në vazhdimësi të këtij shërbimi sipas standarteve të kërkuara.

- Ne ato raste kur gjëndja teknike e kontenierit është jo e mirë dhe i papërshtatshëm për funksionin e tij, pas larjes dhe dizifektimit do të hiqet nga shërbimi dhe do të riparohet nga vetë operatori ekonomik.
- Operatori ekonomik duhet të ketë (një) makinë teknologjike **autofshesë** për fshirjen e rrugëve (fshese mekanike), te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës, dhe me dokumentacion të rregullt për qarkullim.